



KONFERENCA

Sfidat dhe arritjet e mbikëqyrjes publike në përmirësimin e cilësisë të auditimit ligjor dhe raportimit financiar

19 Nëntor 2024 Tiranë, Shqipëri

KONFERENCA

Sfidat dhe arritjet e mbikëqyrjes publike në përmirësimin e cilësisë të auditimit ligjor dhe raportimit financiar

19 Nëntor 2024, Salla Jeronim De Rada, Hotel Plaza
Tiranë, Shqipëri

HYRJE

Kjo konferencë organizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) si pjesë e projektit për Forcimin e Cilësisë së Auditimit dhe Raportimit ([SQARP](#)), financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Objektivi i SQARP është të forcojë kapacitetet e palëve të interesuara për të përmirësuar, aplikuar dhe zbatuar raportimin financiar të njësive ekonomike në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Ky projekt është zhvilluar bazuar në një qasje të programuar për të përmirësuar zbatimin e raportimit financiar të njësive ekonomike në Shqipëri dhe po ofron mbështetjen e nevojshme për vazhdimin e reformës në këtë fushë dhe përforcimin e punës së mëparshme reformuese. Projekti është vijimësi e projekteve të mëparshme: Projekti i Përmirësimit të Raportimit Financiar të Korporatës ([CFREP](#), faza I) dhe Projekti i Rritjes së Cilësisë së Raportimit Financiar ([EQFINREP](#), faza II).

Iniciativa aktuale për të ndryshuar ligjin e auditimit për përafrim më të mirë me acqui të BE-së, duke përfshirë dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë, aktualisht mbështetet në kuadër të programit rajonal të financuar nga BE Rruga drejt Evropës, Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimit Institucional për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme ([REPARIS for SMEs](#)). Gjithashtu, Shqipëria është një vend përfitues i programit rajonal të Programit të Përmirësimit të Kontabilitetit, Auditimit dhe Raportimit të Qëndrueshmërisë ([EAASURE](#)) i bashkëfinancuar nga Ministria Austriake e Financave dhe SECO. Një nga synimet e këtij programi është të mbështesë axhendën e reformës së qëndrueshmërisë në vendet përfituese deri në vitin 2028. Të dy programet rajonale koordinohen nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar ([CFRR](#)).

Ndërgjegjësimi i publikut për përfitimet dhe ndikimin në ekonomi të raportimit financiar cilësor i njësive ekonomike dhe shpërndarja e rezultateve të SQARP në përmirësimin e kuadrit institucional dhe performancës së organizatave profesionale përkatëse në fushën e raportimit financiar janë pjesë integrale e aktiviteteve të projektit.

Konferenca thekson reformat e vazhdueshme që synojnë përmirësimin e raportimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Nisma e reformës fokusohet në përmirësimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e profesionit të kontabilistëve dhe audituesve ligjorë dhe forcimin e cilësisë së raportimit financiar. Duke nxitur një qeverisje dhe transparencë më të mirë, kjo përpjekje siguron që raportimi financiar të përputhet me standardet ndërkombëtare, duke rritur nivelin e ekosistemit të përgjithshëm financiar në vend.

Përgjatë kësaj konference, ne do të zbulojmë zhvillimet kryesore në lidhje me aktivitetet e parashikuara në Projekt, me fokus të veçantë në ndikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të sigurimit të cilësisë për 2018-2023 të ndërmarra nga BMP, me objektivin për të siguruar që auditimi ligjor të kryhet në një mjedis të kontrolluar, transparent dhe të kujdesshëm që i shërben interesit publik.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kërkesave për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë të paraqitura në ligjin e ri të auditimit, si një komponent kyç i projektit të harmonizimit me Direktivën e Auditimit të BE-së. Do të prezantohet edhe një panoramë e zhvillimeve më të fundit në kërkesat etike dhe konsideratat etike në raportimin e qëndrueshmërisë dhe dhënies së sigurisë për këtë raportim, duke siguruar ndërgjegjësim të mëtejshëm me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare për raportimin e qëndrueshmërisë dhe dhënies së sigurisë për këtë raportim.

RENDI I DITËS | E MARTË, 19 NËNTOR 2024

08:45 Regjistrimi i pjesëmarrësve

09:10 Fjala Përshëndetëse

Z.Dritan Fino, PhD | Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike

TBC | Përfaqësues i Bankës Botërore

Zj.Brigitte Bruhin | Drejtuese e Programit | Zhvillimi i Sektorit Privat | Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike - SECO

Z.Petrit Malaj | Ministër i Financave

10:00 Prezantimi i Projektit të Bankës Botërore – SQARP – Arritjet deri më sot

Ministria e Financave (MF), në bashkëpunim me përfituesit e tjerë të projektit, po udhëheq zbatimin e reformës për përmirësimin e raportimit financiar të njësive ekonomike në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare, nëpërmjet zbatimit të projektit SQARP (financuar nga SECO Zvicerane dhe i zbatuar me mbështetjen e Bankës Botërore). Ky panel do të theksojë aktivitetet e projektit në vazhdim dhe rezultatet e arritura.

Panelistët:

Erjola Vejsati | Drejtor Ekzekutiv, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) – Prezantim i aktiviteteve në lidhje me forcimin e sistemit të mbikëqyrjes së auditimit dhe ndikimi në cilësinë e auditimit dhe raportimit financiar

Prof.Dr. Sotiraq Dhamo | Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM)- Prezantim i aktiviteteve në lidhje me rritjen e kapaciteteve të profesionit kontabël në Shqipëri për të eksportuar/kontraktuar shërbimet e kontabilitetit në nivel ndërkombëtar dhe zhvillimin e profesionit të kontabilitetit ligjor

Sean Sweeney | Eksporti i Shërbimeve të Kontabilitetit | Prezantim i gjetjeve dhe kërkimeve të realizuar në lidhje me mundësitë e tregut, kostot dhe përfitimet nga eksportimi i shërbimeve kontabël nga anëtarët e organizatave profesionale

Marsela Vaska | Drejtor, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve | Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) | Prezantim mbi strategjinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në zbatimin e IFRS 17

Ela Qokaj | Kancelare, Shkolla e Magjistraturës | Prezantim mbi aktivitetet e projektit për rritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe gjyqtarëve me njohuri në fushën e raportimit financiar, kontabilitetit, auditimit si dhe të fushave të lidhura me to

- Pyetje dhe Përgjigje

Moderatorët:

Andrei Busuioc | Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

Vasilika Vjero | Zëvendësministër i Financave

11:30 Pushim për kafe

12:00 Kuadrin e zhvillimit të raportimit të qëndrueshmërisë dhe dhënies së sigurisë

Ky panel do të fokusohet në kuadrin e zhvillimit të raportimit të qëndrueshmërisë dhe dhënies së sigurisë, me një theks të veçantë në kërkesat etike, kornizat rregullatore dhe zhvillimet kombëtare. Sesioni do të fillojë me një prezantim mbi konsideratat më të fundit etike në raportimin e qëndrueshmërisë dhe dhënien e sigurisë, duke paraqitur njohuri mbi udhëzimet e Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA) dhe lidhjen e tyre me kërkesat në rritje për transparencë në praktikat e qëndrueshmërisë.

Një përfaqësues nga Ministria e Financave të Shqipërisë, do të vijojë panelin me një prezantim të dispozitave të parashikuara si pjesë e ndryshimeve në ligjin e auditimit me fokus në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe të ardhmen e afërt të raportimit të qëndrueshmërisë në Shqipëri.

Një përfaqësues i një prej shoqërive të auditimit nga rrytetet e mëdha ndërkombëtare, do të mbyllë sesionin me një panoramë të sfidave dhe mundësive të tregut shqiptar në tranzicionin drejt raportimit të qëndrueshmërisë dhe dhënies së sigurisë për këtë raportim.

Christelle Martin | Anëtare e Bordit të BSNEPK (IESBA) – Kryetare e grupit të punës për Etikën në Raportimin e Qëndrueshmërisë dhe Dhënien e Sigurisë - prezantim mbi zhvillimet më të fundit mbi kërkesat përkatëse etike dhe Konsideratat e Etikës në dhënien e sigurisë dhe raportimin e qëndrueshmërisë

Erisa Rodhani | Përgjegjës Sektori, Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, Drejtorja e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar - Prezantim për kuadrin rregullator lidhur me raportimin e qëndrueshmërisë dhe të ardhmen e afërt të raportimit të qëndrueshmërisë në Shqipëri

Enida Cara | Partnere për Auditimin dhe Dhënien e Sigurisë, Deloitte Albania - Prezantim mbi panoramën e sfidave dhe mundësive të tregut shqiptar në tranzicionin drejt raportimit të qëndrueshmërisë dhe dhënies së sigurisë lidhur me këtë raportim

- Pyetje dhe Përgjigje

I Ftuar:

Eduard Shalsi | Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë.

Moderatori:

Dritan Fino, PhD | Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

13:15 Dreka

14:15 Sfidave dhe arritjeve në fushën e auditimit

Ky sesion synon të ofrojë një kuptueshmëri të plotë të sfidave dhe arritjeve në fushën e auditimit, me fokus të veçantë në ndikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të sigurimit të cilësisë të realizuara nga BMP nga viti 2018 deri në 2023. Duke nënvizuar rolin kritik që sjellja etike, kultura e firmës dhe mbikëqyrja efektive luajnë në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së auditimit. Arritjet në rritjen e transparencës, pavarësisë së audituesit dhe efektivitetit të mbikëqyrjes do të theksohen gjithashtu, duke ofruar njohuri mbi progresin e bërë në forcimin e cilësisë së auditimit.

Prezantimi pasues do të ofrojë një pasqyrë më të thellë të situatës aktuale në lidhje me cilësinë e auditimit, duke shqyrtuar në rrënjë shkaqet dhe faktorët sistematikë që ndikojnë në performancën e audituesit. Diskutimi do të theksojë rëndësinë e mekanizmave të kontrollit dhe masave disiplinore, etikën dhe rolin e kulturës së shoqërisë së auditimit dhe ndikimin përkatës në cilësinë e auditimit. Për më tepër, prezantimi do të fokusohet në rëndësinë e kryerjes së analizës rrënjësore së shkaqeve për të identifikuar dhe trajtuar çështjet e përsëritura në praktikat e auditimit. Zhvillimet aktuale në sektorin e auditimit, duke përfshirë tendencat në zhvillim si mungesa e talenteve, investimet në kapitalin privat, përdorimi i teknologjisë, etj.

Erjola Vejzati | Drejtor Ekzekutiv, Bordi Mbikëqyrjes Publike - prezantim i sfidave dhe arritjeve në mbikëqyrjen e auditimit

Janine van Diggelen | Konsulent ndërkombëtar i Projektit SQARP - prezantim për të dhënë një pasqyrë të situatës aktuale mbi cilësinë e auditimit dhe shkaqet e tyre rrënjësore, rëndësinë e kontrollit dhe masave disiplinore, etikën dhe kulturën e shoqërive të auditimit dhe të analizës rrënjësore së shkaqeve, si edhe zhvillimet aktuale në sektorin e auditimit

- Pyetje dhe Përgjigje

Moderatori:

Erjola Vejzati | Drejtor Ekzekutiv, Bordi Mbikëqyrjes Publike

15:45 Fjala përmbyllëse

16:00 Fundi i konferencës

REPARIS FOR SMEs finançohet nga



European Union

SQARP finançohet nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO